



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**

**NJOFTIM PER SHTYP**

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) ka shpallur listat paraprake të fituesve për Skemat Kombëtare Mbështetëse, për Masat Direkte, financuar nga buxheti i shtetit, programi “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, për vitin 2018. Pas përfundimit të fazës së aplikimit, kryer në periudhën Shkurt – Mars 2018, përmes një procedurë transparente dhe të thjeshtuar, online, mbi bazën e parimit “0 Dokumenta” në momentin e aplikimit, pranë 36 pikave të aplikimit (Agropika/zyra të Drejtorive të Bujqësisë/zyrave rajonale të AZHBR-së), është regjistruar një numër i lartë fermerësh. Në përputhje me fondin në dispozicion për skemat kombëtare mbështetëse, AZHBR do të financojë mbi 80% të aplikimeve totale për masat direkte, dhe konkretisht për:

- Mbjellje të reja
- Krerë të lindur dhe matrikulluar
- Mbështetje për bletari
- Mbështetje për dorëzimin e qumështit lëndë e parë
- Çertifikim standarti ISO, dhe Çertifikim të enëve
- Prodhim të bostanorëve, polenizim dhe automatizim në serra
- Ferma organike
- Mbështetje për pikat e grumbullimit dhe fermerët
- Plotësim i numrit të bimëve në ullishtet e vjetra

Do të disbursohen në masën 100%, dhe me rialokimet e ardhshme do të rritet përqindja e financimit kryesisht në skemat mbështetëse si: Ujitje me pika, Instalimi i sistemit të ngrohjes së serrave, Zëvendësim i plastmasit të serrave, Vendosija e rrjetës kundër breshërit.

Listat paraprake janë publikuar në faqen zyrtare të AZHBR-së, dhe fermerët aplikantë kanë marrë informacion për çdo fazë përmes publikimit të listave në faqen e agjencisë dhe në ambjentet e pikave të aplikimit. Data e fundit për dorëzimin e dokumentave shtesë është 24 maj 2018.

Aktualisht, masat e investimeve janë në fazën e shqyrtimit dhe do të kontaktohen sipas rastit me shpresë të gjithë aplikantët. Fondi i programit “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, për vitin 2018, miratuar nga buxheti i shtetit dhe që menaxhohet nga AZHBR me funksionet e “Agjencisë së Pagesave”, është 20 Milionë Euro. Ky fond do të shpërndahet për mbështetjen e 52 masave mbështetëse, që kanë të bëjnë me zhvillimin rural, agroturizmin, rritjen e sipërfaqes së tokës së punuar, rritjen e sigurisë ushqimore etj.

---

Për më shumë informacion jeni të lutur të referoheni faqes zyrtare të AZHBR-së për të njohur me listat paraprake dhe informacionin e nevojshëm: [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), Adresa: Rruga “Muhamet Gjollësja”, Nr. 56, Tiranë, Tel: 042228318, [info@azhbr.gov.al](mailto:info@azhbr.gov.al)